



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA VUSHTRRI



Zyra e Komunikimit me Publikun

Njoftim për faljen e borxheve

Vushtrri, 16 tetor 2015

Komuna e Vushtrrisë njofton të gjithë qytetarët se ka hyrë në fuqi Ligji për faljen e borxheve. Falja e borxheve sipas këtij ligji bëhet për obligimet e pashlyera të qytetarëve ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike. Më këtë ligj falen borxhet e krijuara deri më 31 dhjetor 2008.

Kushtet për falje të borxheve janë:

- Të kryhen pagesat e plota të obligimeve për periudhën nga 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Më këtë rast do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e borxhit bazë për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014
- Të lidhen marrëveshje me Institucionin Shtetëror apo Ndërmarrjen Publike për pagesën e borxheve me këste për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Në rastin kur arrihet marrëveshjet, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe faljen e ndëshkimeve për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014.

Për borxhet e pashlyera deri më 31 dhjetor 2008, ku shuma totale e borxhit bazë është në vlera të vogla prej një (1) deri njëqind euro (100), këto borxhe do të fshihen me automatizëm.

Subjektet që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas ligjit, këtë të drejtë mund ta realizojnë brenda periudhës prej një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi e ligjit për Falje të Borxheve.

Për informata më të hollësishme në lidhje me faljen e borxheve mund të drejtoheni në Komunën e Vushtrrisë, Zyrën e Tatimit në Pronë.

Për të parë listën e borxhlinjve si shumë e borxhit, si dhe shumë se sa borxhe falen, për secilin person fizik dhe juridik klikoni në linkun: